



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 18, dt. 21.12.2022

**MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT  
PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936, dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2023”, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e buxhetit të vitit 2023, Vendimit të Këshillit të Qarkut “Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2023-2025 për Këshillin e Qarkut”, VKM nr. 673 dt. 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publike”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

**V E N D O S I**

1. Të miratojë Planin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2023 si më poshtë:

<b><i>Të ardhurat e Këshillit të Qarkut</i></b>	<b><i>gjithsej</i></b>	<b><i>174.6 milion lekë</i></b>
Nga kjo	- Transferta e pakushtëzuar	70 milion lekë
	- Transferta e kushtëzuar	6.7 milion lekë
	- Të ardhurat vendore	54.4 milion lekë
	- Te ardhura nga fondet e Programeve të BE	43.5 milion lekë
<b><i>Shpenzimet e Këshillit të Qarkut</i></b>	<b><i>gjithsej</i></b>	<b><i>174.6 milion lekë</i></b>
Nga kjo	Funksionet e veta	
	- Për administratën e Këshillit të Qarkut	30.1 milion lekë
	- Për shpërblimin e antarëve të Kryesisë të Këshillit të Qarkut	1.0 milion lekë
	- Për investime në Këshillin e Qarkut	36.8 milion lekë
	- Kontribut bashkëfinancim në Proj. BE	85.7 milion lekë
	- Projekti STEP	0.2 milion lekë
	- Projekti “Qendra ditore të moshës së tretë” në bashkëpunim me Bashkinë Korçë	3.0 milion lekë
	- Projekti “Vemendje, kujdes dhe shërbime cilesore për moshën e tretë” në bashkëpunim me Bashkinë Maliq	1.0 milion lekë
	- Projekti “Festa Zones Mokres” në bashkëpunim	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**  
**Sektori i Financës, Zhvillimit Ekonomik, Shërbimeve, Burimet njerëzore**  
**dhe zhvillimit të teritorit**

**RELACION**  
**MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2023”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, administrata e Këshillit të Qarkut ka punuar për hartimin e shifrave të buxhetit për vitin 2023.

Për hartimin e buxhetit jemi mbështetur në:

- Programi buxhetor afatmesëm 2023-2025 të miratuar nga Këshilli I Qarkut.
- Raportin për monitorimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2022 për periudhën 8/mujore.
- Analiza financiare e realizimit të pritshëm të treguesve ekonomike për vitin 2022.
- Mundësitë reale të realizimit të burimeve të të ardhurave, si kusht për financimin e shpenzimeve.
- Programi i aktiviteteve për vitin 2023 për institucionin e Këshillit të Qarkut të lidhura këto me objektivat e zhvillimit të qeverisjes qëndrore.
- Normativat e lejuara të shpenzimeve të miratuara me akte ligjore dhe nënligjore.

**Së pari ju paraqesim nje analizë të shkurtër të realizimit të buxhetit për vitin 2022.** Zbatimi i buxhetit për vitin 2022 ka ecur në kushte normale, kjo si rezultat I një planifikimi të mbështetur mbi burime reale të të ardhurave të vetë institucionit.

- **Realizimi i shpenzimeve**

Realizimi i pritshëm i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2022 do të jetë 63.7 milion lekë, nga 129.8 milion leke të planifikuara të planifikuara ose 49% .  
Më poshtë po analizojmë realizimin e shpenzimeve të planifikuara vetëm për vitin 2022.

***Realizimi i pritshëm i shpenzimeve për vitin 2022***

Nr.	Emertimi	Plan vjetor	I pritshmi	P/F %
	Shpenzimeve	2022	2022	2022
I	<b>Admin. K.Qarkut</b>			
	- paga administrata	14869400	12810280	86.15
	- sigurime administrata	2520000	2089683	82.92
	- shpen.operative+vendim gjyqi	8200000	6472513.7	78.93
	- shperb.antaret Kryesise Kesh. Qarkut	1000000	900000	90.00
	- investime	50921827.7	12180712	23.92
	- Projekti Save Ëater	15420000	1004682	6.52
	- Projekti SaveSafe Ëater	0	0	-
	- Projekti Ëaste Rreact	1800000	500000	27.78
	- Projekti Ëincome	0	0	-
	- Projekti CLLD - CULTOUR	12910620	8704183	67.42
	- Pjesemarje ne Projektet e B. European	0	0	-
	- Proj.STEP	159486	0	-
	- Shoqatat e te Verberve	410000	410000	100.00
	- Projekti "Qendra ditore moshes trete"	3000000	3000000	100.00
	Qendra ditore per femijet rome dhe egjiptiane	0	0	#DIV/0!
	- Projekti per moshen e trete me B. Maliq	1000000	1000000	-
	- Qendra Rezidenciale Zhvillimit Korce	150000	0	-
	- Qendra e Kujdesit Paliativ Meri Poter	400000	400000	100.00
	- Projekti Korca Oper Air 2020-2022	400000	400000	100.00
	- Projekte te Shkollave te Mesme	300000	300000	100.00
	- Projekti me Spitalin Rajonal Korce	960000	760000	79.17
	- Proj. Pjesemarje konkursin anglishtfolesve	0	0	-
	- Projekti me Shoqaten Bleteritesve	400000	395000	98.75
	Projekti me gazetaret	0	0	#DIV/0
	- Proj. Festa e zones Mokres Pogradec	100000	100000	100.00
	Proj. me Universitetin Korce	300000	180000	60.00
	Proj. Pastrimi I bregut te liqenit Pogradec	7150080	7150080	100.00
	Aktiviteti mik festival Bashkia Pustec	0	0	#DIV/0
	- Proj me Bashkine Kolonje(piktoret)	800000	800000	100.00
	- Aktivitete e festa ne Bashkite e qarkut	100000	0	-
	- Shperblim nga fondi I vecante	100600	100600	100.00
	- fond rezerve	200000	0	-
	<b>Shuma</b>	<b>123572014</b>	<b>59657733.7</b>	<b>48.28</b>
II	<b>DAMT ne Qark</b>			

	- paga administrata		5200000	3380831	65.02	
	- sigurime administrata		823000	564551	68.60	
	- Shpenzime operative		300000	123203	41.07	
	- Shperblim fondi I vecante				#DIV/0!	
	<b>Shuma</b>		<b>6323000</b>	<b>4068585</b>	<b>64.35</b>	
	<b>TOTAL QARKU</b>		<b>129895014</b>	<b>63726318.7</b>	<b>49.06</b>	

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore ze një peshë të konsiderueshme në buxhetin e vitit 2022 me rreth 17.4 milion lekë. Numri i planifikuar i punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut për vitin 2022 është 10 punonjës + tre titullarët e zgjedhur, kjo sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2022. Ndërkohe këtë vit janë krijuar edhe vakanca për shkak të largimit të disa punonjësve. Kjo shpjegon edhe realizimin e fondit të pagave me 86%. Numri i punonjësve të DAMT në qark është 7 punonjës, numër i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, kurse numri faktik është 5 punonjës, për këtë shkak % e realizimit të pagave të DAMT është 65%. Mbi bazën e këtyre strukturave ka qënë i miratuar edhe fondi për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore. Brenda këtij fondi janë financuar të gjitha pagat e administratës së keshillit të qarkut. Gjate vitit ka vazhduar rregullisht pagesa e sigurimeve shoqërore. Gjatë këtij viti nuk u krijua asnjë detyrim i ri në paga e sigurimeve shoqërore.

Shpenzimet operative të financuara për vitin 2022 aritën në 7.4 milion leke nga 9.4 milion lekë të miratuara dhe kap 12.4 % të totalit të shpenzimeve. Në këtë zë janë futur shpenzimet për financimin e aktivitetit të institucionit. Disa zëra të shpenzimeve nuk janë realizuar 100%, por është planifikuar që pjesa më e madhe e tyre të mbyllen brenda muajit Dhjetor.

Gjate vitit 2022 programi i investimeve është financuar vetëm 12.2 milion lekë nga 50.9 milion lekë. Jane realizuar prokurimet në të gjitha objektet e planifikuara në Bashkitë e Qarkut por financimi i tyre nuk ka filluar. Kontratat mbyllen në vitin në vazhdim ku dhe do vazhdojë financimi. Investimet në infrastrukturë në Bashkitë e qarkut do të vazhdojnë edhe për këtë vit mbi bazën e kërkesave të tyre dhe miratimit në Këshillin e Qarkut.

Në zbatim të rregjistrit të prokurimeve të fondeve publike, të gjitha shpenzimet e prokuruar dhe të realizuara gjate vitit 2022 janë financuar duke mos krijuar asnjë borxh të ri.

Gjithashtu gjatë vitit 2022 janë financuar fonde për të tretë sipas miratimit në buxhetin e Këshillit të Qarkut:

- Pjesëmarrje në Projektin me Bashkinë Korçë “Qendra ditore të mosnës së tretë” me 3 milion leke
- Shoqatat e të verbërve të rajonit me 410 mijë leke.
- Sherbimi i Kujdesit Paliativ Korçë me 400 mijë leke
- Projekti Korça Open Air 2019 me 200 mijë leke

- Projekti me Spitalin Rajonal Korce me 760 mije leke
- Projekti për moshën e tretë me Bashkinë Maliq 1 milion lekë
- Projekti me shoqatën e bletëritësve 395 mijë lekë
- Projekti festa e zonë stë Mokrës 100 mijë lekë
- Projekti me Universitetin e Korcës 180 mijë lekë
- Projekti I pastrimit të bregut të liqenit Pogradec 7.1 milion lekë
- Projekti me Bashkinë Kolonjë për piktorët e vegjel dhe promovimin e Kolonjës në Prishtinë 800 mijë lekë

Pothuajse të gjitha projektet e planifikuara në buxhetin e vitit 2022 janë realizuar.

Gjate vitit 2022 ka ecur mire realizimi i Programeve me fonde të Bashkisë me European dhe kontribut të Këshillit të Qarkut. Nga buxheti i miratuar për vitin 2022 si kontribut në pjesëmarje në keto projekte, janë financuar gjithsej 10.2 milion lekë nga 30.1 milion lekë të planifikuara. Realizimi i këtyre projekteve është në nivele të ulta për faktin se pjesa më e madhe e tyre janë financuar nga fondet që janë celur në llogaritë përkatëse të tyre në bankën e nivelit të dytë.

- **Realizimi i të ardhurave**

Për vitin 2022 burimet e të ardhurave në buxhetin e Këshillit të Qarkut kanë qënë:

*Ne 000/leke*

Te ardhurat	Plani 2022	I pritshmi 2022	Realizim ne %	Diferenca ne vlere
Transferta e pakushtëzuar	58619	58619	100	0
Kontributi financiar I bashkive viti 2022	6000	1900	31.6	4100
Te ardhura nga taksat e tarifave e shërbimeve	1029	356	34.6	673
Te ardhurat e trashëguara viti 2021	64952	64952	100	0
Transferta e kushtëzuar	6323	6323	100	0
<b>Total 2022</b>	<b>136923</b>	<b>132150</b>	<b>96.5</b>	<b>4773</b>

Transferta e pakushtëzuar vazhdon të jetë burimi kryesor i të ardhurave dhe është përdorur për financimin e funksioneve të veta të miratuara me Vendim të Këshillit të Qarkut në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

Vazhdon të mbetet problem realizimi i kontributit financiar të bashkive për llogari të Këshillit të Qarkut. Theksojmë se ky kontribut është burimi kryesor i të ardhurave të vetë institucionit dhe ze një peshë të konsiderueshme në buxhet. Megjithatë ky është një detyrim ligjor, nga ana e bashkive vazhdon të mos bëhet derdhja sipas realizimit dhe % të miratuar në buxhetin e secilës bashki. Për vitin 2022 vetëm 31.6% e këtij zëri të të ardhurave është realizuar me kontributet si më poshtë

Bashkia Korce 500000 lekë  
 Bashkia Maliq 300000 lekë  
 Bashkia Pogradec 1000000 lekë  
 Bashkia Ersekë 100000 lekë

Derdhja e këtij kontributi financiar të Bashkive për vitin 2023 duhet të shihet me prioritet nga të gjitha këshillat bashkiake në procesin e miratimit të buxhetit të tyre për vitin 2023 dhe në vazhdim për derdhjen e kontributit, pasi është një detyrim ligjor.

Të ardhurat e tjera nga tarifave e shërbimeve që ofron institucioni si nga kadastra, urbanistika për periudhën 2022 janë realizuar në vlerë 356 mijë lekë nga 1029 mijë lekë të

planifikuara. Kjo ndodh pasi edhe planifikimi I tyre bëhet vetem mbi parashikime dhe jo mbi llogaritje konkrete për vetë natyrën e këtyre të ardhurave.

Keto ishin disa nga momentet kryesore gjatë zbatimit të buxhetit për vitin 2022

- **Hartimi I buxhetit për vitin 2023**

**Hartimi i buxhetit për vitin 2023 është bërë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2023”, si dhe akteve te tjera ligjore.**

Gjithashtu hartimi i buxhetit për vitin 2023 është parë ngushtë lidhur edhe me problematikat e trajtuara me lart. **Planifikimi i cdo zëri të buxhetit është bërë për të qënë sa më eficient dhe i realizueshëm, me qëllim që gjatë vitit 2023 të kemi mundësi të financojmë buxhetin e këtij viti, të mbyllim pjesën e borxhit të trashëguar dhe të mos krijojmë detyrime të reja.** Për të aritur këtë rezultat duhet një punë me pergjegjshmëri nga i gjithë stafi i administratës së Këshillit të Qarkut. Gjithashtu kërkojmë përgjegjësi nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Qarkut për realizimin e kontributit financiar të bashkive për këshillin e qarkut si detyrim ligjor për organet vendore të nivelit të dytë.

**Planifikimi i të ardhurave**

Për vitin 2023 buxheti total për Këshillin e Qarkut është planifikuar në vlerë 174.6 milion leke(duke përfshirë edhe transfertën e kushtëzuar të DAMT-së) duke synuar për të patur një buxhet sa më real dhe te mbuluar me fonde të realizueshme.

Të ardhurat si burim i financimit të shpenzimeve janë planifikuar mbi bazën e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Transferta e pakushtëzuar vazhdon të mbetet e ardhura kryesore e buxhetit për organin vendor. **Per vitin 2023 Granti është celur në masën 70.025 milion lekë, me një rritje nga viti 2022 prej rreth 12 milion lekë.**

Në planifikimin e të ardhurave janë mbajtur parasysh aktet ligjore në fuqi si dhe realizimi i tyre në periudhat e mëparshme. **Të ardhurat e veta në total janë planifikuar në masën 6.6 milion lekë.**

Ne planin e të ardhurave peshën kryesore e kapin të ardhurat nga kontributi financiar I bashkive përbërëse të këshillit të qarkut. Kjo e ardhur është **planifikuar mbështetur në Ligjin 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” neni 38, pika 3, ku citohet shprehimisht se kuota e anëtarësisë të bashkive përbërëse për financimin e buxhetit të qarkut percaktohet me vendim të këshillit bashkiak. Kjo rit përgjegjesinë e Bashkive për të planifikuar dhe derdhur në kohë këtë detyrim.** Kjo e ardhur në vitet e kaluara është realizuar në nivele të ulta duke krijuar deficite të ndjeshme në buxhetin e këshillit të qarkut dhe kjo për arsye që janë trajtuar shumë herë. Nga ana jonë ky kontribut është planifikuar në nivelin 6 milion lekë, një shifër tepër e realizueshme nga të gjitha bashkitë pa prekur dhe dëmtuar buxhetin e tyre.

Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve që ofron Këshilli i Qarkut, janë planifikuar në nivele më të ulta krahasuar me vitin 2022, në vlerë 610 mijë lekë, pavaresisht se realizimi i pritshëm i tyre është në nivele të ulta. Në këtë planifikim është marë parasysh ecuria e këtyre të ardhurave në disa vite, meqenese nuk mund të bëhen llogaritje të sakta. Në këtë zë futen kryesisht të ardhurat nga tarifat e kadastrës dhe urbanistikes. Këshilli I Qarkut nuk ofron më shërbime në fushën e transportit pasi ato janë kompetencë e vetë bashkive.

Gjithashtu për vitin 2023 janë marë në konsideratë përdorimi i të ardhurave të papërdorura deri tani në vlerë 47.8 milion lekë, të cilat kanë qënë të planifikuara kryesisht si kontribut për pjesëmarje në Programet IPA, si dhe në zërin investime, ku kemi parasysh objektet e prokuruar me përfitues bashkitë e qarkut dhe financimin e tyre në 2023.

Gjithashtu në buxhetin e vitit 2023 është planifikuar një zë për çisbursimin e fondeve me financim të huaj me një limit prej 43.5 milion lekë për të pesta projektet, për ato që aktualisht janë mbyllur si dhe për 3 projektet që janë në zbatim.

Bashkangjitur është pasqyra e tarifave që aplikon Këshilli I Qarkut për shërbimet që I ofron komunitetit, të miratuara këtu me akte ligjore e nënligjore, si dhe pasqyra e llogaritjeve analitike të të ardhurave të parashikuara për vitin 2023.

Në total të ardhurat do të përdoren për financimin e funksioneve të veta të Këshillit të qarkut të miratuara me ligj.

#### **Planifikimi i shpenzimeve**

Pjesë e rëndësishme e planit të buxhetit është planifikimi i shpenzimeve . Nga ana e sektorit të financës planifikimi i shpenzimeve është parë me kujdes në çdo element të saj mbi bazën e zbatimit të Ligjit “Për buxhetin e vitit 2023”, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit si dhe të realizimit të buxhetit për vitin 2022, si dhe mbështetur në miratimin paraprak të dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025. Grupi i punës ka bërë parashikimin e buxhetit për vitin 2023 mbi bazën e programeve dhe aktiviteteve të miratuara.

Në total buxheti për vitin 2023 është planifikuar në vlerën 167.9 milion lekë me burim financimi transfertën e pakushtëzuar me vlerë 70.025 milion lekë, të ardhurat e institucionit për vitin 2023 dhe trashëgimi nga viti 2022 me vlerë 47.8 milion leke si dhe fondi limit prej 43.5 milion lekë që do të shërbejë për disbursimin e fondeve me financim të huaj nga Bankat e nivelit të dytë në llogari të Këshillit të Qarkut pranë Degës së Thesarit. Transferta e pakushtëzuar vazhdon të mbetet një burim i rëndësishëm i financimit të shpenzimeve për Këshillin e Qarkut. Bashkangjitur materialit është tabela analitike e llogaritjes të shpenzimeve të buxhetit.

#### **Planifikimi i shpenzimeve të personelit**

Në zbatim të Ligjit “Për buxhetin e vitit 2023”, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” numri i punonjësve të stafit të administratës të këshillit të qarkut do të vazhdojë të jetë me 10 punonjës dhe 3 titullarë të zgjedhur dhe të emëruar. Në këto kushte si dhe në funksion të punës të Administratës, për vitin 2023 nuk është planifikuar asnjë ndryshim në strukturë. Niveli i pagave ka pësuar një rritje krahasuar me vitin 2022, në zbatim të VKM-së nr 625 dt



28.09.2022 “Për disa shtesa e ndryshime ne vendimin 165 dt. 02.03.2016 te Keshillit te Ministrave "Për grupimin e njësisve të veteqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave te funksionareve te zgjedhur e te emeruar, te nepunesve civile e të punonjësve administrative të njesive të qeverisjes vendore”. Fondi I pagave eshte llogaritur mbi bazen e ketyre te dhenave. **Në vlerë pagat e sigurimet shoqerore për vitin 2023 jane 18.4 milion lekë dhe kapin 14 % të totalit të shpenzimeve. Financimi i tyre është parashikuar me fonde nga transferta e pakushtëzuar.**

Në buxhetin e vitit 2023 është planifikuar edhe financimi i shpërblimit për anëtarët e kryesisë të këshillit të qarkut sipas vendimit përkatës në vlerë 1 milion lekë.

- **Planifikimi i shpenzimeve operative për administratën e Këshillit të Qarkut**

Planifikimi i shpenzimeve për mallra e shërbime të tjera për vitin 2023 për administratën është bërë sipas klasifikimit ekonomik për cdo funksion në vecanti. **Planifikimi i shpenzimeve operative dhe vendimeve gjyqësore për vitin 2023 për funksionimin e administratës së këshillit të qarkut është ne nivelin 11.7 milion lekë ku është parashikuar edhe financimi I borxhit të trashëguar.** Financimi i shpenzimeve operative dhe vendimeve gjyqësore do të bëhet kryesisht me fonde nga transferta e pakushtëzuar , rreth 1.4 milion lekë me të ardhurat e trashëguara dhe 1 milion nga të ardhurat e pritshme për tu realizuar. Niveli i këtyre shpenzimeve kap rreth 9.3 % të totalit.

Niveli i shpenzimeve është planifikuar mbi bazën e normativave të miratuara me akte ligjore për disa zëra shpenzimesh. Niveli i planifikuar i shpenzimeve mbulon aktivitetin e administratës së këshillit të qarkut në permbushje të misionit të tij.

Disa nga zërat që zenë peshë në shpenzimet operative per administratën e K.Qarkut në total janë si më poshtë:

- Planifikimi i shpenzimeve për karburant është llogaritur në vlerë 1 milion lekë ose rreth 900 litra në muaj për automjetin e institucionit në shërbim të administratës. Konsumi I karburantit është llogaritur mbi bazën e normativave te miratuara per vitin 2023.
- Riparimi I automjeteve, blerje goma e bateri si dhe siguracione e taksa te mjeteve eshte llogaritur ne vlere 480 mije leke.
- Blerje kancelari, boje fotokopje e printera eshte llogaritur ne vlere 300 mije leke, si dhe vitin e kaluar.
- Shpenzime per telefoni fikse, internet dhe celulare jane llogaritur ne nivelin 180 mije leke nga te cilat 120 mije leke jane shpenzimet per celulare dhe telefoni fikse. Perdorimi I telefonise celulare do te jete deri ne 4 mije leke ne muaj per kryetarin e keshillit te qarkut, por brenda nivelit 2% te shpenzimeve operative (Art.602) sipas akteve ligjore ne fuqi.
- Shpenzimet postare, energji dhe uje jane planifikuar ne vlere 950 mije leke kjo sipas realizimit te tyre ne vite.
- Shpenzime per aktivitete dhe festa jane planifikuar ne masen 120 mije leke.
- Në vitin 2023 do të zhvillohet edhe Festivali Folklorik I Gjirokastrës. Fondi I parashikuar për këtë festival ze një peshë të konsiderueshme prej 2 milion lekësh.

**Planifikimi I Investimeve**

Për vitin 2023 janë planifikuar rreth 37 milion lekë investime ose 29.8 % të totalit të buxhetit, ku peshën kryesore do ta zenë investimet në infrastrukture si kontribut për Bashkitë e Qarkut sipas objektivave që do të miratohen në Këshillin e Qarkut, në vazhdim të nismës të mare që në vitin 2018. Si dhe vazhdimi i financimit të objekteve të prokuruar në vitin 2022.

Per vitin 2023 është planifikuar edhe blerja e nje automjeti per nevojat e punes të institucionit.

- **Planifikimi i bashkëfinancimit në Projektet e BE**

Për vitin 2023 Këshilli i Qarkut ka miratuar edhe nje fond prej 42.2 milion lekë si pjesë e bashkëfinancimit të Projekteve të fituara me fonde të Bashkimit European. Gjithashtu është miratuar edhe nje limit prej 43.5 milion lekë ne llogarinë Këshillit të Qarkut në Degën e Thesarit, që do të shërbejë për disbursionin e fondeve me financim të huaj nga Bankat e nivelit të dytë në llogari të Thesari (Këshilli I Qarkut).

Po vazhdon implementimi i 3 projekteve IPA, njëri prej të cilëve pritet të mbyllet Brenda vitit 2022. 2 projekte janë mbyllur në vitin 2021. Fondet e parashikuara në buxhet janë planifikuar për 2 projektet qe do të vazhdojnë të zbatohen në vitin 2023 si dhe një pjesë e fondeve janë lënë për projektë të reja ku Këshilli I Qarkut do të jetë pjesë. Institucioni jone duhet te financoje 15 % te vleres si kontribut, gjithashtu jane mare masat edhe per financimin e vleres te TVSF, e cila nuk financohet me fonde te BE, si dhe parafinancimi me qellim ecurine normale te Programeve. Keshilli i qarkut po vazhdon punën për pjesëmarje në thirje të reja të celura nga Bashkimi European në bashkëpunim me partnere rajonale e ndërkombëtarë. Kjo do të bëjë të mundur vazhdimësinë e pjesëmarjes në keto Programe, të cilat do të sjellin nje stad të ri të zhvillimit të rajonit.

- **Shpenzime te tjera**

Keshilli i qarkut në vazhdimësi ka parë mundësinë e financimit për shërbime në kujdesin social. Për vitin 2023 janë planifikuar disa kontribute financiare si më poshtë:

- Projekti “Qendra ditore të moshës së tretë” 3.0 milion leke  
në bashkëpunim me Bashkinë Korçë
- Projekti “Vemendje, kujdes dhe shërbime  
cilësore për moshën e tretë” në bashkëpunim  
me Bashkinë Maliq 1.0 milion leke
- Projekti “Festa ZONES MOKRES” në bashkëpunim  
me Bashkinë Pogradec 0.3 milion leke
- Projekti “KOLONIA E PIKTORAVE TE VEGJEL” në  
bashkëpunim me Bashkinë Erseke 0.2 milion leke
- Aktivitete e festa ne Bashkite e Qarkut 0.5 milion leke
- Për shoqatën e të verbërve 0.5 milion lekë
- Projekti “KORÇA OPEN AIR 2021/2022” 0.4 milion lekë
- Projekti pjesëmarje konkursin anglishtfolës 0.3 milion lekë
  
- Shërbimi i kujdesit paliativ Korçë 0.4 milion lekë
- Qendra Rezidenciale e Zhvillimit Korçë 0.1 milion lekë
- Qendra ditore për fëmijët romë dhe  
egjiptianë 1.0 milion lekë
- Projekti me Shoqatën e Bletëritesve 0.4 milion lekë
- Projekti me Spitalin Rajonal Korçë 0.8 milion lekë

- Projekti me gazetarët për fotoalbumin rajonal	0.5	milion lekë
- Projekti për qepjen e veshjeve krahinore	1.8	milion lekë
- Aktiviteti Mik Festibal Bashkia Pustec	1.4	milion lekë

Keshilli I Qarkut do të ketë prioritet zgjerimin e gamës së financimit në kete sektor.

Për vitin 2023 në buxhet është futur edhe vlera prej 6.7 milion lekë Transfertë e kushtëzuar për financimin e shpenzimeve për funksionimin e Drejtorisë së Administrimit e Mbrojtjes së Tokes në Qark. Ky është një buxhet qe vjen i miratuar me Ligjin e Buxhetit.

**Keto ishin zërat kryesore të Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2023.**

Bashkangjitur ketij material janë pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe pasqyra e buxhetit të përgjithshëm për vitin 2023.

Korce me 16.12.2022

Oljona Beqiraj  
Përgjegjëse e Financës